UDHËZIM
Nr. 6, datë 6.4.2021

PËR ZBATIMIN E KOEFICIENTËVE TË INDEKSIMIT TË BAZËS SË VLERËSUAR NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 196, DATË 31.3.2021 ,"PËR INDEKSIMIN E PENSIONEVE DHE BAZËS SË VLERËSUAR"

Në zbatim të pikës 11, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 196, datë 31.3.2021, "Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar", me qëllim zbatimin e drejtë dhe unik të tij, Instituti i Sigurimeve Shoqërore

UDHËZON:

Në zbatim të pikës 11, të vendimit nr. 196, datë 31.3.2021, të Këshillit të Ministrave, baza e vlerësuar e vitit 2019 do të indeksohet me indeksin 2,8%, të llogaritur sipas kritereve të përcaktuara në nenin nr. 59, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për efekt të llogaritjes së masës fillestare të pensioneve me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 3.10.2018, "Për koeficientët e indeksimit të pagave për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve" dhe me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019, "Për koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2017, për llogaritjen e pensioneve", vendim të Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 30.3.2020, "Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2018, për llogaritjen e pensioneve", shtohen edhe me koeficientin 2.8 për qind, të përcaktuar në pikën "11" të këtij vendimi, konkretisht si më poshtë:

Për pagat referuese deri më datë 31.12.1993	**9.562**
Për pagat e vitit 1994	9.562
Për pagat e vitit 1995	7.696
Për pagat e vitit 1996	5.971
Për pagat e vitit 1997	5.971
Për pagat e vitit 1998	4.989
Për pagat e vitit 1999	4.049
Për pagat e vitit 2000	3.689
Për pagat e vitit 2001	3.155
Për pagat e vitit 2002	2.914
Për pagat e vitit 2003	2.608
Për pagat e vitit 2004	2.369
Për pagat e vitit 2005	2.151
Për pagat e vitit 2006	1.954
Për pagat e vitit 2007	1.867
Për pagat e vitit 2008	1.649

Për pagat e vitit 2009	1.517
Për pagat e vitit 2010	1.452
Për pagat e vitit 2011	1.397
Për pagat e vitit 2012	1.344
Për pagat e vitit 2013	1.288
Për pagat e vitit 2014	1.288
Për pagat e vitit 2015	1.113
Për pagat e vitit 2016	1.113
Për pagat e vitit 2017	1.092
Për pagat e vitit 2018	1.053
Për pagat e vitit 2019	1.028
Për pagat e vitit 2020	1.000
Për pagat e vitit 2021	1.000

Koefiçientët e sipërshënuar aplikohen për rivlerësimin e bazës së vlerësuar të arritur deri në vitin 2021, për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensionit që do të caktohet me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim. Pas aplikimit të tij, baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensionit që do të caktohet me datë fillimi pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, nuk mund të jetë më e lartë, se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 30 000 lekësh, e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 16.12.2020, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", për pagat e periudhës nga viti 1994 deri më 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi prej 130 312 lekësh, e përcaktuar sipas kritereve të paragrafit të fundit të nenit nr. 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

Indeksimi i pagave me koeficientët e pasqyruar më sipër, për efekt të llogaritjes fillestare të pensioneve, do të bëhet vetëm për pensionet me datë lindjeje të së drejtës nga data 1.4.2021 e në vazhdim.

Koeficientët e indeksimit të pagave, të përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 3.10.2018, "Për koefiçentët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve", vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 180, datë 4.4.2019, "Për koefiçentët e indeksimit të pagave, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar për llogaritjen fillestare të pensioneve" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 30.3.2020, "Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2018, për llogaritjen e pensioneve", mbeten në fuqi dhe përdoren për indeksimin e pagave mbi të cilat janë paguar kontributet vetëm për pensionet me datë fillimi deri më 31.3.2021, përfshirë edhe këtë datë referuar datës së lindjes të së drejtës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Astrit Hado